

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRISË - OPSTINA VUČITAN  
Nr. / Id. / Nr. 10997/26  
- A -  
Data / Datum 10.03.2026  
VUČITAN - VUČITAN



REPUBLIKA E KOSOVËS – KOMUNA VUSHTRRI

02 Nr. 155/26 Kryetari  
DT. 10.03.2026



Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 44 paragrafi 1 të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë :

V E N D I M  
PËR FORMIM TË KËSHILLIT ORGANIZATIV

1. Formohet Këshilli Organizativ për organizimin të aktiviteteve me rastin e shënimit të “Ditës së Bibliotekës” në Komunën e Vushtrisë, nga data 24-27 mars 2026.”
2. Këshilli Organizativ ka këtë përbërje:
  - 2.1 Izet Miftari – kryesues
  - 2.2 Florina Krasniqi Mehmeti, anëtare
  - 2.3 Kadrije Meniqi, anëtare
  - 2.4 Sadete Gërguri, anëtare
  - 2.5 Ramadan Kutillovci, anëtar
  - 2.6 Advije Maxhuni, anëtare
  - 2.7 Sami Bislimi, anëtar
3. Kryesuesi i këshillit organizativ do të mbaj takime me anëtarët e Këshillit Organizativ për përgatitjet që duhet të bëhen për shënimin e kësaj dite.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Vendimi iu dërgohet:

- DKRS
- QSHQ
- Arkivit

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRIË QËNDRORË

10683126  
-1-  
13.03.2026



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari



02Nr. 167/26  
Datë, 13.03.2026

Në bazë të nenit 13 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, me 28/04, qershor 2008), neni 43 paragr. 14 dhe 44 paragr. 1 të Statutit të Komunës, neni 10 të Rregullores (KKV) Nr.277/20, dt. 30.12.2020 për Përoaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim më pak se një vit të Pronës së Paluajtshme të Komunës, si dhe kërkesën e Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dt. 10 Mars 2026, Kryetari i Komunës merr këtë:

**V E N D I M  
P E R F O R M I M T Ë K O M I S I O N I T**

1. Formohet komisioni vlerësues për shqyrtim të kërkesave të parashtruara në Drejtorinë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, për më pak se një vit.
2. Në përbërje të komisionit caktohen:
  - 2.1 znj. Ilirjana Azemi, kryesuese e komisionit
  - 2.2 z. Islam Latifi, anëtar
  - 2.3 z. Nexhmedin Peci, anëtar
3. Komisioni, me rastin e shqyrtimit të kërkesave për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, do të bazohet në Rregulloren e (KKV) Nr.277/20, dt. 30.12.2020 për Përoaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim më pak se një Vit të Pronës së Paluajtshme të Komunës.
4. Komisioni ka mandat dy vjet nga dita e nënshkrimit të këtij vendimi (paragr. 3 i nenit 10 të Rregullores).
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



**Vendimi iu dërgohet:**

- Anëtarëve të komisionit
- QSHQ
- Arkivit



REPUBLICA E KOSOVËS  
KOMUNA E VUSHTRRI

Drejtori / Dir. 11247/26  
Nr. / Nr. 1  
Data / Datum 19.03.2026



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI  
Kryetari

02Nr. 263/26  
Datë, 18.03.2026

Bazuar në nenin 13 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 44 paragrafi 1 të Statutit të Komunës, dhe Rregulloren KKV nr.01/2024 nr. protokollit 01-56/2024 date 28.03.2024 për Përkrahjen e Fermerëve në Bujqësi dhe Bizneseve në Sektorin Privat, Kryetari i Komunës merr këtë:


**V E N D I M**

1. Lejohet subvencionimi i fermerëve të komunës së Vushtrrisë mbarështues të bletëve me nga 5 euro për koshere.
2. Pagesa të bëhet për 117 (njëqind e shtatëmbëdhjetë) fermerë të Komunës së Vushtrrisë të cilët janë të përfshirë në listën e DBZHR në shtojcë të këtij vendimi, e që janë përfitues të këtij subvencionit. Numri i koshereve që subvencionohet është 11125 vlera për pagesë 55,625.00 euro
3. Pagesat të kryhen nga mjetet buxhetore (subvencionet dhe transferet) të Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural dhe Drejtoria për Buxhet e Financa.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural
- QSHQ
- Arkivit



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

02Nr. LOS/26  
Datë, 18.03.2026


Bazuar në nenin 13 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 44 paragrafi 1 të Statutit të Komunës, dhe Rregulloren KKV nr.01/2024 nr. protokollit 01-56/2024 date 28.03.2024 për Përkrahjen e Fermerëve në Bujqësi dhe Bizneseve në Sektorin Privat., Kryetari i Komunës merr këtë:


### V E N D I M

1. Lejohet subvencionimi i fermerëve të komunës së Vushtrrisë mbarështues të deleve dhe dhive me nga 5 euro për krerë, dhe subvencionimi për fermer të komunës së Vushtrrisë që mbarështojnë buallica me nga 100 euro për krerë.
2. Pagesa të bëhet për 31 (tridhjetë e një) fermerë të Komunës së Vushtrrisë të cilët mbarështojnë dele e dhi të cilët janë të përfshirë në listën e DBZHR e që janë përfitues me nga 5 euro për krerë, dhe 2 (dy) fermerë përfitues që mbarështojnë buallica me nga 100 euro, e që vlera e gjithmbarshme për subvencionim për dele, dhi dhe buallica është 16,745.00 euro.
3. Pagesat të kryhen nga mjetet buxhetore (subvencionet dhe transferet) të Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural dhe Drejtoria për Buxhet e Financa.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

#### Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural
- QSHQ
- Arkivit





REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

02Nr. 211/26  
Datë, 19.03.2026

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 43 paragrafi 14 dhe 44 paragrafi 1 të Statutit të Komunës, me kërkesë të UNDP-së lidhur me realizimin e projektit MCP nga ReLOaD3 datë 04 mars 2026, Kryetari i Komunës merr,

**V E N D I M**  
**PËR THEMELIM TË KOMISIONIT PËR MONITORIM TË PROJEKTEVE TË OJQ-ve NË**  
**PROGRAMIN RAJONAL PËR DEMOKRACINË LOKALE NË BALLKANIN PERËNDIMOR**  
**(ReLOaD3)**

1. Themelohet Komisioni për monitorim - Komuna e Vushtrrisë në partneritet me UNDP të OJQ-ve me rastin e zbatimit të përfituesve të projekteve.
2. Në përbërje të komisionit monitorues nga Komuna e Vushtrrisë caktohen:
  - 2.1 Liridon Lahu, anëtar
  - 2.2 Remzije Zekolli, anëtar
  - 2.3 Bashkim Sadiku, anëtar rezervë
  - 2.4 Anëtarët tjerë të këtij komisioni do të caktohen nga përfaqësues të projektit ReLOaD3.
3. Anëtar i rezervë do të zëvendësoj në rast nevojë anëtarin e Komisionit monitorues i cili ka konflikt interesi me ndonjërin prej aplikuesve për këtë projekt.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Vendimi i iu dërgohet:

- Anëtarëve të Komisionit monitorues
- Znj. Vlora Elshani
- QSHQ
- Arkivit



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOMUNALE  
KOMUNA E VUSHTRRISË  
Nr. / ID: 11386126  
- 1 -  
Data / Datë: 23-03-2026  
KOMUNA E VUSHTRRISË



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI  
Kryetari

02Nr. 212/26  
Datë, 14.03.2026

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 43 paragrafi 14 dhe 44 paragrafi 1 të Statutit të Komunës, me kërkesë të UNDP-së lidhur me realizimin e projektit MCP nga ReLOaD3 datë 04 mars 2026, Kryetari i Komunës merr,

**V E N D I M**  
**PËR THEMELIM TË KOMISIONIT VLERËSUES PËR VLERËSIM TË PROJEKTEVE TË OJQ-**  
**ve NË PROGRAMIN RAJONAL PËR DEMOKRACINË LOKALE NË BALLKANIN**  
**PERËNDIMOR (ReLOaD3)**

1. Themelohet Komisioni Vlerësues për vlerësim të projekteve të OJQ-ve Komuna e Vushtrrisë në partneritet me UNDP sipas thirrjes publike të datës 09.02.2026.
2. Në përbërje të komisionit vlerësues nga Komuna e Vushtrrisë caktohen:
  - 2.1 **Khavit Mehmeti**, anëtar
  - 2.2 **Liridon Hajdini**, anëtar
  - 2.3 **Florijana Leku**, anëtare rezervëAnëtarët tjerë të këtij komisioni do të caktohen nga përfaqësues të projektit ReLOaD3.
3. Anëtari rezervë do të zëvendësoj në rast nevojë anëtarin e Komisionit Vlerësues i cili ka konflikt interesi me ndonjërin prej aplikuesve për këtë projekt.
4. Komisioni Vlerësues me rastin e vlerësimit të aplikacioneve dhe përzgjedhjes së përfituesve do të zbatoj procedurat e përzgjedhjes konform rregullave ligjore me të cilat është e rregulluar kjo çështje.
5. Vendimi lryn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Vendimi i ju dërgohet:

- Anëtarëve të Komisionit Vlerësues
- Znj. Vlora Elshani
- QSHQ
- Arkivit.